



**BASHKIA KORÇË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE**  
**MENAXHIMIT TË KONTRATAVE TË INFRASTRUKTURËS**

Nr. 11520/1 Prot.

Korçë, më 20.12.2024

**KËSHILLI BASHKIAK**  
Bashkia Korçë

Lënda: Trajtim i problematikave të ngritura.

Në vijim të shkresës Nr.11520 Prot datë 03.12.2024 të Këshillit Bashkiak Korçë në lidhje me procesin e “Konsulimeve Publike”, me kërkesa dhe shqetësimë të banorëve të Rajonit 1, 2 dhe 3 të qytetit të Korçës si dhe kërkesat apo shqetësimet e ngritura gjatë takimeve të kryera me banorët në Njësitë administrative të Bashkisë Korçë të cilat janë ruajtur me procesverbal ju informojmë si më poshtë :

Në lidhje me termoizolimin e pallateve të para viteve 90, si cdo vit Bashkia Korce do të jetë në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për të qënë pjesëmarrës aktiv në thirjen e tyre, si dhe në buxhetin e 2025 është parashikuar një fond për investimet në banesat në bashkëpronësi.

Në lidhje me asfaltimin e disa rrugëve në qytet Bashkia Korçë ka parashikuar Investime në Infrastrukturën rrugore si dhe do të fillojë Inspektimi I tyre për të ndjekur nga afër problematikat dhe për ti përmbyllur Brenda vitit 2025.

Për sa I përket shtimit të hapësirave të gjelbra, mjediseve clodhëse dhe këndeve të lojërave përfëmijë Bashkia Korçë ka parashikuar një fond në Buxhetin e 2025, gjithashtu ka filluar me projektet të cilat do të përmbyllen Brenda vitit 2025.

Në lidhje me problematikën e qenërvë endacakë nga Bashkia Korçë është bërë planifikimi I Fondit të Matrikullimit/Sterilizimit si dhe është vendosur në dispozicion ambient për qentë endacakë në mënyrë që të mos jenë problem shqetësues për banorët e komunitetit.

Për sa i përket problematikës në lagjen 17, për koshin e mbeturinave I cili nuk zbraset shpesh Bashkia Korçë ka marrë në konsideratë problematikën e ngritur nga banorët si dhe ka kryer monitorimet përkatëse në mënyrë periodike duke zgjidhur problematikën e komunitetit.

Në lidhje me problematikën e paraqitur nga banorët e Lagjes 1 për sa i përket kabujve të linjave të telefonave apo internetit, nga ana e Bashkisë Korçë është filluar eleminimi I linjave telefonike ajrore në disa zona, në të cilat po kryhet edhe termoizolimi I pallateve. Për sa I përket Lagjes 1 do të vijojmë bashkëpunimin me AKEP sepse duhet të kryhet eleminimi I linjave ajrore dhe

krijimi i një linje nëntokësore por duke qënë se kjo zonë është qëndër historike nuk mund të kryhen ndërhyrje të menjëherëshme.

Për sa I përket ankesës së kryer nga banorët e lagjes 4 për sa I përket mungesës së gjelbërimit, NSHP-ja ka marrë në konsideratë ankesën si dhe do të përmبushë këtë kërkesë Brenda vitit 2025.

Për sa i përket konviktit Bashkia Korce ka kryer ndërhyrje të vazhdueshme dhe aktualisht është duke kryer një studim në lidhje me rrjetin hidraulik.

Në lidhje me ankesën e kryer nga banorët e lagjes 1 për sa I përket restaurimit të shkallëve që të cojnë tek Varrezat e deshmorëve, Bashkia Korce ka parashikuar në buxhetin e 2025 një fond për restaurimin e shkallëve.

Për sa I përket pallatit në lagjen 5, pallati përballë Klinikës “Kristi”, nga Bashkia Korce është ngritur një grup I cili do të kryejë verifikime dhe do të vijojë me ndërhyrje në rast se është e nevojshme.

Për sa i përket pallatit në lagjen 4, ngjitur me shkollë “Nuci Naci” nga ana e Bashkisë Korce do të vijohet me verifikimin në terren dhe marrjen e masave për riparim nëse është e nevojshme.

Për sa i përket problematikës në lagjen 6 tek ish reparti ushtarak nga ana e Bashkisë Korce është bërë parashikimi në buxhetin e vitit 2025.

Kërkesat dhe shqetësimet e banorëve të Njësive Administrative :

Për sa I përket problematikave të shprehura në Njësinë Administrative Vithkuq, në lidhje me ujin e pijshëm si dhe problematikave me ujrat e zeza Bashkia Korce është në bashkëpunim të vazhdueshëm me UKKO për zgjidhjen e problematikës së krijuar.

Për sa i përket problematikës për hapjen e rrugës nga bora si çdo vit janë marrë masa nga NSHP-ja për pastrimin e rrugëve.

Problematikat e tjera të shprehura nga banorët janë parashikuar në buxhetin e vitit 2025.

Për të vijuar më tej me kërkesat dhe problematikat e banorëve të Njësisë Administrative Voskopojë dhe Lekas vijojmë si më poshtë me informacionin :

Bashkia Korce do të jetë në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit si dhe me UKKO për zgjidhjen e problematikave, në fshatin Gjonomadh, Lekas, Lavdar, Shipskë dhe Krushovë.

Në lidhje me fshatin Voskopojë ku kërkohet caktimi I një vendi për ndërtimin e stallave jashtë fshatit jemi duke marrë informacion nga ASHK-Korçë për zgjidhjen e problematikës

Për sa I përket problematikave të shfaqura nga banorët e Njësisë Administrative Voskop ju bëjmë me dije se në lidhje me fshatrat Vincan, Goskovë dhe Polenë, Bashkia Korçë është në bashkëpunim me UKKO për zgjidhjen e problematikave.

Në lidhje me ndërhyrjen për asfaltim të rrugës së Dërsnikut ju bëjmë me dije se do të përmbyllët Brenda vitit 2025 pasi kjo rrugë është përzgjedhur nga Fondi Shqiptar I Zhvillimit si dhe do të fillojnë punimet.

Për sa I përket problematikave të fshatit Voskop dhe Damjanec do të merren në konsideratë si dhe janë parashikuar në buxhetin e Vitis 2025.

Për të vijuar më tej me Komunën Mollaj, konkretisht me fshatin Mollaj në lidhje me pjesën e pastrimit janë marrë masa dhe po kryhen kontrollle sipas grafikut në mënyrë që të ketë efikasitet.

Për sa I përket fshatit Mollaj dhe Kamenicë nga NSHP-ja është parashikuar në Buxhetin e Vitis 2025.

Në lidhje me Njësinë Administrative Drenovë ju informojmë se Bashkia Korçë është në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit si dhe UKKO Korçë për të zgjidhur problematikat e shprehura nga Banorët e Njësisë.

Vijojmë me Njësinë Administrative Bulgarec dhe ju informojmë se NSHP-ja ka parashikuar në buxhetin e 2025 fond për zgjidhjen e problemeve si dhe Bashkia Korçë është në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe UKKO Korçë për zgjidhjen e problematikave.

Ju faleminderit për mirëkuptimin !

**KRYETARI I BASHKISË  
Sotiraq Filo**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
ZV/KRYETARE  
Besa Spaho**

